



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO**



**KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE**

Nr. i Protokollit: 02/563

Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Gllavicë

E premte, më 16 qershor 2023

Kohëzgjatja e takimit: 16:20 –17:30

Vendi i takimit: SHMFU "Lasgush Poradeci"

Të pranishëm ishin: Kryesuesi i Kuvendit- Adnan Ademi; Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emini dhe Drejtori i Shërbimeve Publike - Bardhyl Rushiti.

Rendi i ditës:

1.Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026

Këtë takim e hapi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Shtimes, z. Adnan Ademi, i cili ka përshëndetur të pranishmit dhe i ka falënderuar që kanë gjetur kohë të marrin pjesë në takimin për Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin 2024-2026. Z. Ademi tregoi që ne sot jemi këtu për të marrë kërkesat e juaja për vitin 2024 për investimet kapitale, duke shtuar që buxheti i Republikës së Kosovës gjithmonë ndahet në bazë të numrit të banorëve, në këtë rast edhe Komuna e Shtimes në bazë të numrit të banorëve e përfiton edhe buxhetin ose grantet qeveritare nga Thesari i shtetit. Ai më tutje dha sqarime sa i përket ndarjes së buxhetit të Komunës së Shtimes dhe tha se si qeverisje duhet t'i marrim prioritet dhe kërkesat e juaja, kryesisht kërkesat e banorëve të fshatit Gllavicë dhe t'i vendosim në buxhetin për vitin 2024.

Pas përfundimit të fjalimit të tij, z. Ademi ia dha fjalën për sqarime shtesë Drejtorit për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Grejtalb Emini.

Drejtori Emini, përshëndeti të pranishmit dhe filloi me sqarimet sa i përket investimeve të cilat janë bërë dhe janë duke vazhduar në të njëjtën kohë. Ai përmendi me radhë rrugët të cilat do të asfaltohen, ndriqohen dhe rrugëve të cilave do t'iu vendoset trotuari, të cilat brenda këtij viti do të përfundojnë. Më tutje ai tha se sa i përket vitit 2024 dhe investimeve të cilat do të bëhen, së bashku me banorët e fshatit Gllavicë do të vendosen prioritetet dhe kërkesat e tyre që do të jenë në buxhetin e vitit të ardhshëm.

Kërkesat e banorëve të fshatit Gllavicë:

- **Shaban Krasniqi:** Lagjja te “Gurët”, nr. 44, lagjja “Gashi” nr. 30, lagjja “Krasniqtë”, lagjja “Hoxhtë” rrugët të rregullohen me asfalt. Të rregullohet trotuari prej rrugës kryesore deri tek oborri i shkollës. Probleme me ujësjellës tek lagjja “Gashi”.
Të bëhet një park në Gllavicë, si dhe kërkesa e fundit rruga “Muhamet Gashi” të asfaltohet.

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve ne mbledhjen e Bordit te Drejtoreve.

Date: 16.06.2023

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nenshkrimi
1	Shaban	Krasniqi
2	Artan	Gashi
3	Selim	Zegllari
4	Imri	Gashi
5	Milazmi Gashi	M. Gashi
6		
7		
8		
9		
10		
11		
12		
13		
14		
15		
16		